



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Fatmir Krasniqi	22.04.2025	30.04.2025	2025/0275

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.04.2025, OE “Infra-Plus SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0275, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Infra-Plus SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zhvillimi i projektit ideor dhe te hollesishem [zbatues kryesor], te arkitektures dhe te inxhinierise, per ndertimin e Stadiumit te ri ne Rahovec, ne perputhje me Kategorine II plus te rregulloreve dhe udhezimeve teknike per infrastrukture te stadiumeve, te miratuara nga UEFA. RITENDERIM” me nr. të prokurimit: "207-24-9503-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, (konkurs projektimi), lloji i kontratës: shërbim. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Nenin 1 te LPP-se

Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Nenin 52 te LPP_se

Nenin 55 te LPP_se

Nenin 59 te LPP_se

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Infra-Plus SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadimeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM**” me numër të prokurimit: “**207-24-9503-2-2-3**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Neni 25 te RRPP 002/2024

Neni 25 të LPP-së

Neni 40 te RRPP 002/2024

Neni 10 i UOPP 001/2023

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i vlerësimit është ngarkuar në platëformën e-prokurimi me dt. 01.04.2025

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me dt 24.04.2025 kërkesë AK-së për dorëzimin e kopjes fizike të ofertës së rekomanduar për kontratë.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Infra-Plus SH.P.K.**

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur (konkurs i projektimit), vlerë e mesme, lloji i kontratës shërbim.

AK me dt. 11.09..2024 ka publikuar Njoftimin për Konkursin e Projektimit ndërsa hapja e ofertave financiare është bërë me dt. 18.03.2025 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar pese operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me dt. 01.04.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë ka rekomanduar për kontratë OE SHM Architecture Sh.p.k., Kodi 4919 vlere e ofertës 96,000.00€ dhe numëri i pikëve totale 97 pikë. Ndërsa ofertën e OE ankues komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar si ofertë të përgjegjshme/pasukseshme duke e vlerësuar me pikë totale prej 69.25pikë

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 07.04.2025 brenda afatit ligjor. AK me dt.10.04.2025 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pabazuar, vlenë të ceket fakti se AK në vendimin e saj nuk i ka arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore.

OE i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt. 17.04.2025 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional dhe kapacitetin ekonomik financiar, pasi që dëshmitë e dorëzuara si per qarkullimin ekonomik dhe ato te stafit sa i përketë përvojës nuk përkojnë me kërkesat e dosjes se tenderit.

Pas shqyrtimit të provave shkresore sqarojmë se, procedura e zhvilluar nga AK është konkurs projektimit dhe se ofertat janë dorëzuar në formë fizike tek AK. Me dt 24.04.2025 përmes platëformës kam kërkuar nga AK dorëzimin e kopjes fizike të ofertës së rekomanduar për kontratë të cilën e kam pranuar në kopje. Dokumentat e kontestuara nga OE ankues – sa i përketë mos përmbushjes së kërkesës për kapacitetin teknik dhe profesional, për kontratat e realizuar dhe stafin profesional të kërkuar per menaxherin e kontrates, AK në dosje të tenderit kishte vendosur kërkesat si në vijim;

Kërkesa 1.1 -Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme për të zbatuar në mënyrë efektive kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për shërbime projektimi. Për këtë qëllim, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka zbatuar kontrata për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore, shuma e grumbulluar e të cilave duhet të tejkaloj 150,000.00 € [një-pesë-zero, zero-zero-zero, zero-zero euro]

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.1. -Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dorëzoj [i] Kontratat dhe Raportet e pranimit të projekteve shërbimeve,

të lëshuara nga Autoritetet kontraktuese publike private OSE [ii] Certifikatat ose Referencat e përfundimit me cilësi të lartë, të projekteve shërbimeve, të lëshuara nga Autoritetet kontraktuese publike private -Një [1] kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri, për secilën dëshmi dokumentare. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.2

-Për secilën nga kontratat e deklaruara, ne kornize te ‘Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.1.’, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të plotësoj ‘Tabelën 1’, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave tekstuale dhe numerike, si dhe të fotografive, në katër [4] faqe [bashkërisht me tabelën në fjalë] me madhësi A4 -Një [1] kopje e tabelës 1, e plotësuar, e kompletuar dhe e dorëzuar sipas kërkesës, veçantë për secilën kontratë të dekluarar. Shënim me rendësi- Kërkesa 1.1. -Ndërtesat publike shoqërore, në rastin e kësaj lënde aktiviteti të prokurimit, nënkupton dhe përfshinë të gjitha tipologjitë e ndërtesave të sportit, të kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të administratës [nën-administrim pronësi shtetërore- lokale qendrore (brenda dhe jashtë Kosovës), nën-administrim pronësi të shteteve të tjera ose të organizatave ndërkombëtare (brenda dhe jashtë Kosovës)], ndërsa përjashton të gjitha tipologjitë e ndërtesave të shërbimeve dhe tregtare [nën-administrim pronësi private]; të gjitha tipologjitë e ndërtesave të banimit shumë-katesh, si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera funksionale [nën-administrim pronësi private] dhe të gjitha tipologjitë e ndërtesave të industrisë dhe të magazinimit; dhe të gjitha tipologjitë e infrastrukturës së transportit dhe teknike dhe të tjerave të ngjashme [duke mos pasur parasysh formën e administrimit pronësisë], si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera hapësinore funksionale.

Pas shqyrtimit të provave shkresore konstatohet se dokumentat e kontestuara nga OE ankues – sa i përketë mos përmbushje së kërkesës së dosjes së tenderit për kontratat e realizuara në tri vitet e fundit nga OE të rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në kopjen e ofertes te OE te rekomanduar te paranuara nga AK, OE i rekomanduar për ta përmbushur kërkesën e dosjes kishte dorëzuar gjithësej 3 referenca të lëshuara nga autoritetet private, me përshkrime te 6 projekteve te relaizuara. Në referencën e lëshuar me dt. 10.01.2024 nga Krapu Com SHPK, thuhet se OE i rekomanduar për kontratë, ka realizuar fazën projektuese të instalimeve sipas kontratës paramases me EU në Dëshmorët e Qendresës -Gllareve-Klinë në vlerë prej 37,000.00€ në shkollën Kuvendi i Lezhës-Viti në vlerë prej 51,790.00€ dhe në shkollën Shaban Shala-Podujevë në vlerë prej 3000.00€ në projektin “ Refurbishment of schools in Kosovo” pra në këtë referencë janë paraqitur tri projekte mbrenda saj. Në referencën tjetër të lëshuar nga Ada Consulting Group SHPK, janë paraqitur dy projekte, për nga përmbajtja është e njëjtë me referencën e mëparshme këtu dallon vetëm emri i shkollave siç janë, Shkollat Dardania në Prishtinë në vlerë prej 67,300.00€ dhe shkolla Metush Krasniqi në Kamenicë në vlerë prej 43,150.00€. Vlenë të ceket fakti se në këtë referencë thuhet se vlera totale e kontratës (projektim dhe ndërtim) është 5,920,902.98€ dhe e vetmja dëshmi është referenca e lëshuar me dt.08.01.2024 nga Ada Consulting Group SHPK. Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe një referencë të lëshuar nga Mediteran Project d.o.o ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë ka “realizuar projektin detal për lagjen San Lorenzo – Kroaci” në vlerë 218,264.26€. AK në arsyeshmerine e vendimit te dt 10.04.2025 kur refuzon si të pa bazuar kërkesën për ris-shqyrtim për kete pretendim ankimor, potencon faktin se bazuar ne nenin 65 paragrafi 3 i LPP-se, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të vlerësojë nëse operatori ekonomik i përmbushë

kriteret e kualifikimit përmes referencave të paraqitura, përfshirë ato të cilat përvojën relevante apo në shërbime të ngjashme. Madje AK vazhdon arsyemsherinë duke potencuar bazën ligjore në udhëzimin administrativ me numër 01/2017 për përgatitjen e dosjes së tenderit dhe kriterëve të kualifikimit, për hire të korrektësitë këtë udhëzim nuk kemi mundur ta gjejm pasi që nuk është i publikuar në web faqen e KRPP-se. Andaj në rastin konkret, vlerësojmë se komisioni i themeluar për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së dhe nenin 52 paragrafi 7 i LPP-së, kur ka rekomanduar për kontratë OE SHM Architecture Sh.p.k., Kodi 4919 pa e bërë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit, sepse në bazë të referencave të dorëzuara e të paraqitura më lartë është e pamundur të vërtetohet përvoja e punës siç është kërkuar në dosje të tenderit nga AK: që Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme për të zbatuar në mënyrë efektive kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për shërbime projektimi. Për këtë qëllim, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka zbatuar kontrata për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore, shuma e grumbulluar e të cilave duhet të tejkaloj 150,000.00 € [një-pesë-zero, zero-zero-zero, zero-zero euro]. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i parë i palës në ankesë është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor, se menaxheri i projektit nuk ka dorëzuar dëshmi konform kërkesës së dosjes së tenderit mbi përvojën e punës, eksperti shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit kishte vendosur kërkesën si në vijim;

Kërkesat B- Fuqia profesionale Kërkesa 1 Udhëheqësi kryesor- Komponenti Arkitektura [Menaxheri i kontratës projektit] -Një [1] person profesionist.

Kërkesa 1.1. Arsimi -Fusha e studimeve Arkitekturë Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1. Arsimi -Diplomë të Nivelit 6- Sistemi i arsimit të lartë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [KKK]- Niveli Bachelor, nga 180 deri në 240 ECTS -Një [1] kopje e origjinalit, e vetëtuar nga noteri. Kërkesa 1.2. Përvoja profesionale -Dhjetë [10] vite përvojë profesionale në hartimin e projekteve të hollësishme të arkitekturës. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2.1. Përvoja profesionale -Biografi të hollësishme [Curriculum Vitae]- [Përvoja profesionale përfshinë vetëm periudhën pas arritjes së kualifikimit arsimor të kërkuar] -Një [1] kopje e nënshkruar nga personi i propozuar, dhe e vulosur nga Operatori ekonomik. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2.2. Përvoja profesionale -Referenca të punës të cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale të paraqitur në Biografinë e hollësishme -Një [1] kopje e nënshkruar dhe të vulosur nga punëdhënësi- për secilin punëdhënë paraprak. Kërkesa 1.3. Angazhimi në projekt -Kontratë ose para-kontratë në emër të këtij projekti. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.3. Angazhimi në projekt -Kontratë ose para-kontratë në emër të këtij projekti. -Një [1] kopje e nënshkruar dhe të vulosur nga Operatori ekonomik dhe personi i propozuar.

Bazuar në kopjen fizike të pranuar nga AK, për ofertën e OE të rekomanduar kishte dorëzuar listën e stafit me gjithësej 10 arkitekt të diplomuar dhe deklaratë për caktimin e menaxherit të projektit përmes të cilës kishte caktuar z. Krenar Veseli si menaxheri i projektit me gjithësej 14 vite përvojë punë.

Pë z. Krenar Veselin kishte dorëzuar, diplomën, kontratën për kryerjen e shërbimeve, CV-në dhe referencat. Bazuar në Cv-në e dorëzuar z. Veseli ka të realizuara projekte të ndryshme në ndërtimin e objekteve dhe disa hartime të projekteve ideor dhe kryesor, kurse të gjitha referencat e bashkangjitura nga ana e tij dëshmojnë përvojën e punës vetëm në ndërtimin e objekteve, e jo edhe në hartimin e projekteve siç është kërkuar në dosje të tenderit, më poshtë do të listojmë referencat e dorëzuara me ofertë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë për përvojën e z. Krenar Veseli.

-Ministria e punëve të brendshme; “Ndërtimi i objektit të universitetit të Mitrovicës faza III” me numër prokurimi 202-15-096-511 lloj i kontratës punë;

-Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtin; “Ndërtimi i Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë” me numër prokurimi 90400/14-15/070-019/511 punë;

-Akademia e Kosoves për siguri Publike; “Renovimi i objekteve të AKSP-se” me numër prokurimi 214-15-19-521, punë;

-Ada consulting Group SH.P.K; “Ndërtimi i objektit afaristo-banesor- Prishtinë, punë;

-Ada consulting Group SH.P.K; “Renovimi Gjeneral i Aneksit të Emergjencave Ekzistuese në QKUK me numër prokurimi 206/11/12/511, punë;

-Ministria e Administratës Publike; “Ndërtimi i Ndërtesës së MFSK-se me numër prokurimi MAP-202-11-031-511 punë;

-Ada consulting Group SH.P.K; “Ndërtimi i konviktit të ri për AKSP- Vushtrri, punë;

-Ada consulting Group SH.P.K; “Ndërtimi i objektit të akomodimit Prishtinë, punë;

-Control Products SHPK; “Punime ndërtimore në objektin poligoni i qitjes në Vushtrri-punë;

-Control Products SHPK; “Punimet finale në objektin Rekonstruimi i shkolës Muze në Suharekë-punë;

-Ben-af; “Ndërtimore i Objektit të Qendrës Tregtare Ben-af në Lipjanë- punë;

-Ben-af; “Ndërtimi i Objektit afaristo-banesor B+P+11 Ben-af në Suharekë- punë;

-Ben-af; “Ndërtimi i Objektit afaristo-banesor B+P+7 Ben-af në Prizeren- punë;

-Ben-af; “Ndërtimore i Objektit të Qendrës Tregtare Ben-af në Malishevë- punë.

Siç vërehet nga dëshimitë e bashkangjitura menaxheri i projektit i caktuar nga ana e OE të rekoamnduar për kontratë përvojën e punës e ka në mbikqyrje të projekteve ndërtimore e cila nuk përkon me kërkesën e dosjes së tenderit e që është kërkuar Përvoja profesionale -Dhjetë [10] vite përvojë profesionale në hartimin e projekteve të hollësishme të arkitekturës. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2.2. Përvoja profesionale -Referenca të punës të cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale të paraqitur në Biografinë e hollësishme. Vlerësojmë se në rastin konkret, komisioni për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit, ka

vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-se kur ka rekomanduar për kontratë OE SHM Architecture Sh.p.k., Kodi 4919, pasi që menaxheri i projektit i caktuar dhe inxhinierët nuk ka ofruar dëshmi mbi përvojën e punës në vitet e kërkuara në hartimin e projekteve të hollësishme të arkitekturës. Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se e njëjta situatë është edhe për pretendimet ankimore me numër rendor 3 dhe 4 ku të gjitha referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë për inxhinieret e paraqitur në list kanë të tëjmë me nderim dhe renovim të objekteve dhe jo me hartimin e hollësishëm të projekteve siç është kërkuar në dosje të tenderit. Andaj mbi këtë bazë vlerësojm se pretendimet me numër 2,3,4 dhe 5 të palës në ankes janë të qëndrueshme.

Lidhur me pretendimin numër 6, këtë e kemi sqaruar tek elaborimi i pretendimit të parë, duke potencuar faktin se në bazë të dëshmive të dorëzuara e kemi të pamundur të vërtetojm fakti se OE i rekomanduar për kontratë me të vërtetë përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me realizimin e kontratave në tri vitet e fundit në vlerë prej 150,000.00€ në hartimin e projekteve. Referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë e të paraqitura tek sqarimi për pretendimin e parë janë të paqara sepse i përkasinë natyrës projekto e ndërto dhe se nuk është e ndarë vlera e projektit të projektimit. Bazuar në dëshmitë e pranuar nga ana e AK-së nuk kemi hasur ndonjë kërkesë për sqarimin e këtyre dokumenteve konform nenit 72 të LPP-se, me ç’rast vlerësojmë s ekomisioni i vlerësimit të përshtatshmërisë së kandidatit, në rastin konkret ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 72 të LPP-se kur ka rekomanduar për kontratë OE pa i kërkuar sqarime lidhur me referencat e dorëzuara. Andaj mbi këtë bazë vlerësojm se pretendimi me numër 6 i palës në ankes është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor se OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit tek kapaciteti ekonomik financiar, Eksperti shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit kishte vendosur kërkesën si në vijim;

Kërkesa 1.2. -Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure. Për këtë qëllim, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, nga kontratat që kanë të bëjnë me shërbimet për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore, në vlerë mbi 200,000.00 € [dy-zero-zero, zero-zero-zero. zero-zero euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2. -Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; -Kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator ekonomik] -Një [1] kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri. Shënim me rendësi- Kërkesa 1.2. -Ndërtesat publike shoqërore, në rastin e kësaj lënde aktiviteti të prokurimit, nënkupton dhe përfshinë të gjitha tipologjitë e ndërtesave të sportit, të kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të administratës [nën-administrim pronësi shtetërore- lokale qendrore (brenda dhe jashtë Kosovës), nën-administrim pronësi të shteteve të tjera ose të organizatave ndërkombëtare (brenda dhe jashtë Kosovës)], ndërsa përjashton të gjitha tipologjitë e ndërtesave të shërbimeve dhe tregtare [nën-administrim pronësi private]; të gjitha tipologjitë e ndërtesave të banimit shumë-katesh, si të veçanta apo

të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera funksionale [nën-administrim pronësi private] dhe të gjitha tipologjitë e ndërtesave të industrisë dhe të magazinimit; dhe të gjitha tipologjitë e infrastrukturës së transportit dhe teknike dhe të tjerave të ngjashme [duke mos pasur parasysh formën e administrimit pronësisë], si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera hapësinore funksionale.

Bazuar në dëshmitë e pranuar nga AK, OE i rekomanduar për kontratë për ta përmbytur kërkesën e dosjes së tenderit kishte dorëzuar vetëm “Vërtetimin e Qarkullimit” të lëshuar me dt 31.12.2023 nga Pro Credit Bank. Vlerësojmë se në rastin konkret dëshmia e dorëzuar nuk përmbyshë kërkesën e dosjes së tenderit për shkak se nuk përmbanë të dhëna nëse qarkullimi është bërë nga kontratat që kanë të bëjnë me shërbimet për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore, në vlerë mbi 200,000.00€

Bazuar në dëshmitë e pranuar nga ana e AK-së nuk kemi hasur ndonjë kërkesë për sqarim të bërë nga AK lidhur me dokumentin e lartpërmendur konform nenit 72 të LPP-se, me ç'rast vlerësojmë se komisioni i vlerësimit të përshtatshmërisë së kandidatit, në rastin konkret ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 72 të LPP-se kur ka rekomanduar për kontratë OE pa i kërkuar sqarime lidhur me vërtetimin e qarkullimit pasi që nuk ka ndonjë dëshmi se ai qarkullim është bërë nga kontratat e shërbimeve në zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore në vlerë prej mbi 200,000.00€ siç është kërkuar në dosje të tenderit. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi numër 7 i palës në ankesë është i qëndrueshëm.

Më tej, Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin numër 8 të OE ankues, AK me dt. 11.09.2024 përmes platëformës e-prokurimi kishte bashkangjitur dokumentin e emurtur “1_1_DT_11092024_Shqip.pdf” në këtë dokument në faqen 5 të tij ishte shënuar; Shënim me rendësi:

- Afati kohor për zbatimin e kontratës është njëqind-e-njëzet (120) ditë;

Bazuar në dëshmitë e pranuar nga AK, lidhur me ofertën e dorëzuar nga OE i rekomanduar, vërehet se tek pjesa III. Oferta Financiare, tek pika 3 e saj OE i rekomanduar për kontratë ka deklaruar se nëse koncepti i projektit jonë fiton për fazën e projektimit, ne marrim përsipër të bëjmë nënshkrimin e kontratës dhe të dorëzojmë projektin e detajuar inxhinierik në brendë njëqind e njëzet (120) ditëve, përfshirë (30) ditë shtesë pas periudhës në fjalë, pas nënshkrimit të kontratës. Vlerësojmë se formulari i ofertës i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit pasi që parasheh kohë më të gjatë të realizimit të projektit se ajo e përcaktuar në dosje të tenderit prej 120 ditëve. Poashtu eksperti shqyrtues sqaron se koha e realizimit të projektit nuk ishte paraqitur si nën-kriteri që mund të vlerësohej me pikë nga ana e komisionit pasi që kriteri i dhënies është tenderi ekonomikisht më i favorshëm, por në rastin konkret afati kohor për realizimin e projektit ishte i specifikuar fikësisht në 120 ditë dhe se formulari i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit. **Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi numër 8 i palës në ankesë është i qëndrueshëm.**

Si përfundim, eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vlerësimi i ofertave, të bëhet në përputhje të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“Infra-Plus SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadimeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM”** me numër të prokurimit: **“207-24-9503-2-2-3**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

plotë me nenin 59 paragrafi 4 dhe nenin 72 paragrafi 1 i LPP-së në atë mënyrë që lejojnë trajtim të barabartë më mes të operatorëve ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Infra-Plus SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM**” me numër të prokurimit: “**207-24-9503-2-2-3**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Infra-Plus SH.P.K.**

Fatmir Krasniqi

